

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Mendoj se këtë diskutim timin sot më shumë duhet t'ua adresoj qytetarëve dhe specifikisht atyre të Durrësit, jo neve këtu në sallë, sepse me sa shikoj ne kemi qëndrime dhe jo mendime. Do ta nis nga një analizë që do t'i bëj portit aktual të Durrësit, edhe si qytetar i asaj zone, edhe sepse besoj që me përjashtim të ndonjërit këtu e njoh më mirë atë zonë dhe atë terren. Po ju them se aktualisht ai është një port që 70% të hapësirës sot nuk është se e ka të pashfrytëzueshme, por e ka një hapësirë e cila shkakton ndotje. Pra, po ju them se qytetarët e Durrësit dhe kush e njeh kalatën lindore, ata që e kanë shtëpinë përballë saj, kur dalin në ballkon, shohin edhe pluhur kromi.

Në Tiranë nuk vjen kjo ndotje, kështu që ju në Tiranë mund të qeshni, se nuk e shikoni. Po flisja për qytetarët e Durrësit, për ata për të cilët ju po flisnit sikur ju dhimbseshin. Puna në këtë port do të fillojë pikërisht në zonën për të cilën po flisja, e cila nuk do të prekë punën aktuale që po zhvillon Autoriteti Portual i Durrësit. Për këtë arsye, askush nga ata që po kryen aktivitet, qoftë edhe tregtarët, nuk duhet të shqetësohen. Puna do të vazhdojë rrjedhshëm. Edhe një gjë tjetër doja t'ju thosha që, kur thoni "porti i Durrësit", duhet ta keni parasysh se ai nuk është porti i Durrësit, nuk është porti i qytetarëve të Durrësit. Kush ka shkuar atje, e ka parë që është si Muri i Berlinit: hyni dhe dilni me leje, se, në qoftë se hyni pa leje, nuk dilni dot më. Kështu që ai nuk është porti i Durrësit aktualisht dhe Bashkia e Durrësit nuk ka përfitime.

Ndaj, kur ta trajtoni atë çështje, mos e trajtoni si një çështje të qytetit të Durrësit, por më mirë trajtoheni si një çështje që ju bën nder për efekt politik dhe jo si çështje me përfitime ekonomike për qytetarët tanë. Për sa u përket nostalgjikëve, te porti i vjetër, kush është tamam nostalgjik, duhet të mbajë mend zbritjen e princ Vidit te porti, tek ish-Banka Kombëtare Tregtare dhe duhet të thoni që duhej të kishim ruajtur atë standard porti, sepse ky i sotmi nuk është për nostalgji. Të mos bëhemi këtu më katolikë se Papa. Atëherë, qytetarëve durrsakë, dhe këtë e kam edhe në raport me disa kolegë të mi të opozitës, shpeshherë dhe ndoshta me të drejtë, u kanë thënë: shikoni, po ju gënjejnë, nuk do ta bëjnë

atë port! Pra, kjo ka qenë formula që përdorej në qytetin e Durrësit: deputetët e opozitës na nxirrnin për gënjeshtarë se nuk do ta bënim.

Sot që po e bëjmë, jemi të këqij se po e bëjmë. Aty do të flasim edhe për punësim, çështje kjo e cila, gjithashtu, është përcaktuar në marrëveshje bashkë me prioritetet. Subjektit në fjalë, pra investitorit strategjik, i janë përcaktuar disa kushte ku prioritet do të kenë subjektet shqiptare dhe rrjedhimisht do të kenë edhe qytetarët shqiptarë në punime dhe punësim në raport me subjektet e huaja, kuptohet, për të njëjtën cilësi punimesh. Pra, këtu do të ketë edhe një standard punimesh kjo. Punësimi i 12 mijë personave me paga sipas standardeve do të sjellë përfitime edhe për sa u përket kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe në mënyrë direkte do të mbulojë barrën që ka diferenca midis kontribuesve dhe përfituesve për sa u përket kontributeve të sigurimeve shoqërore. Siç e thanë edhe kolegët pak më parë këtu, kalata dhe kanali hyrës nuk i transferohen si pronësi subjektit që do të kryejë investimin.

Ka pasur shumë mendime kontradiktore, të cilat i kam hasur shpesh, që subjekti do ta fillojë investimin, por nuk do ta përfundojë se gjoja nuk ka lekë. Në marrëveshje është përcaktuar se në fazën që subjekti ndërpret punimet si rezultat i paaftësisë paguese, ai është i detyruar të transferojë kuotat për 67%-ëshin me vlerë tregu dhe në këtë rast vlera e tregut është parashikuar të jetë zero lek. Cili investitor do t'i hynte detit në këmbë duke e ditur se nuk ka lekë dhe ato 200 milionë dollarë do t'i humbte? Pra, kjo nuk qëndron si logjikë ekonomike. Dikush tjetër thoshte që do të rrisë kostot dhe po i njëjti person nga ana tjetër thoshte se është pastrim parash. Kush merr pak vesh nga ekonomia, e kupton që nuk qëndron si parim, sepse ai që bën pastrim parash nuk rrit kostot.

Pra, në rastin e subjektit në fjalë nuk kemi të bëjmë me asnjërin nga këto të dyja. Ju dhe qytetarët shqiptarë duhet të kenë parasysh që asnjë vendim i një rëndësie të veçantë nuk kalon pa miratimin dhe aprovimin e palës shqiptare, ndryshe, siç standardet dhe ligjet për shoqëritë tregtare përcaktojnë kuorumin kur një vendim kalon, në këtë rast pjesa më e madhe e vendimeve të rëndësishme duhet të kalojnë me 75%. Pra, shteti shqiptar ka mundësinë dhe të drejtën e vetos. Për sa i përket pamundësisë së financimit, për të cilën fola edhe pak më parë, financimi do të bëhet me një pjesë të kapitalit, që është i përcaktuar në aktin e themelimit, me rifinancim të fazës së parë dhe fazës të dytë, me përcaktimin që, ndryshe nga çfarë përcaktohet në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike, që është 10%, në këtë rast është përcaktuar 30%, për të mbrojtur interesat dhe garancitë e ndonjërit që dyshon lidhur me investimin, kurse pjesa tjetër është borxh, vetëfinancim dhe hua.

Unë dua t'u bëj një sfidë të gjithë atyre që e përmendin këtë pjesë. Kush nga ju ka blerë një shtëpi me lekë cash dhe asnjëri me hua? Pra, përpara se ta përmendni atë si argument, dhe unë e kisha shumë miqësisht me tregtarët, duhet të dini se kur niset një aktivitet, nuk do të thotë që aktiviteti të ketë likuiditet për projektin përfundimtar që do të ketë. Këtu u tha që po i falim tokën. Më lejoni t'ju citoj një deklaratë të gushtit 2006: "Ne do ta vazhdojmë përpjekjen tonë për ta ndryshuar Shqipërinë në më të lirë dhe më të mirë për investimet e huaja dhe vendase, duke ofruar tokën për 1 euro, kualifikimin e punëtorëve për 1 euro, ujin teknologjik për 1 euro, shërbimet e tjera për 1 euro, regjistrimin e biznesit për 1 euro, hyrjen në Shqipëri për 1 euro". Kur them "1 euro", e kam fjalën për territorin kudo, në Durrës, në Fier, në Vlorë, në Elbasan, tani për tani.

"Kjo do të thotë se ajo tokë publike apo e kompensuar privatëve do të jetë disponibël për investime. Në këto zona investitori do ta ketë të garantuar truallin me 1 euro". Më thoni pak, çfarë ndryshimi ka 33%-ëshi ynë nga ky 1 euroshi juaj? Unë e kuptoj edhe pretendimin e opozitës, sepse realisht Durrësi është bërë një atraksion turistik, ndryshe nga të gjitha reklamat dhe antireklamat që janë bërë në të kaluarën. I kemi parë investimet që janë bërë në Durrës. Aktualisht po bëhet një investim në shëtitoren e plazhit, Lungomarja, që është një investim fantastik, Eco-Park-u, porti i ri turistik dhe porti tregtar që do të bëhet në Porto Romano. Në qoftë se mendoni se të gjitha këto investime e çojnë probabilitetin e rikthimit në pushtet në Bashkinë e Durrësit drejt zeros, keni të drejtë dhe vazhdojeni këtë lojë. Mirupafshim!